



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
REKTORATI

Nr. 714 Prot

Gjirokastrë, më 21.04.2026

MIRATOI

Prof. dr. Jaho CANA  
REKTOR



**Lënda:** Shtyrje e afatit për aplikime për projekte kërkimore - shkencore të financuara nga UGJ

Në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të UGJ-së datë 30/08/2021, Nr. 976 Prot., Kreu IX për "Kërkimin shkencor", neni 80 për "Projektet e kërkimit shkencor", Universiteti i Gjirokastrës shpall shtyrjen e afatit të aplikimit për "Projekte të Kërkimit Shkencor" për vitin 2026.

Duke u bazuar në Urdhrin Nr. 06, Nr. 586 Prot., datë 01.04.2026 dhe numrin e ulët të aplikimeve të paraqitura deri më datë 31.03.2026, e cila përbënte edhe afatin përfundimtar për dorëzimin e projekt-propozimeve, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë vendos:

- **Shtyrjen e afatit** për dorëzimin e projekt-propozimeve, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe sigurimin e një konkurrueshmërie më të gjerë ndërmjet aplikantëve;
- **Rishikimin dhe përditësimin e Aneksit 2 (Forma e buxhetit)**, duke lejuar fleksibilitet të zërave të buxhetit në mënyrë që të përshtatet me natyrën e projekt-propozimeve sipas fushave prioritare të përcaktuara për këtë thirrje.

## FUSHAT PRIORITARE

Në kuadër të misionit të tij për mbështetjen e kërkimit shkencor, UGJ fton të aplikojnë personel akademik me kohë të plotë nga të tre fakultetet, të cilët janë të interesuar të angazhohen për të kontribuar në fushat si vijon:

- Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënie;
- Zhvillimi linguistik dhe historic;
- Sistemet e teknologjisë së informacionit;
- Biodiversiteti dhe mjedisi;
- Zhvillimet demografike;
- Turizmi i qëndrueshëm;
- Trashëgimia kulturore;
- Shkencat infermiere;
- të tjera.

## QËLLIMI I THIRRJES

Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushat prioritare, përmes financimit me grante nga institucioni, të propozuara nga kërkues shkencorë në UGJ.

Objektivat e thirrjes janë:

- Të mbështesë me grante projekte kërkimore të cilësisë së lartë që mundësojnë rritje të performancës së kërkuesve dhe institucioneve.
- Të mbështesë projekte kërkimore që kanë në fokus fushat prioritare.
- Të mbështesë projekt propozime që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me biznesin, të cilat adresojnë përmirësime në teknologji, procese dhe produkte, nëpërmjet inovacionit, duke kontribuar në përmbushjen e misionit të tretë të Universitetit.

## BUXHETI, FINANCIMI DHE KOHËZGJATJA

- Buxheti total në dispozicion të kësaj thirrje është 6.000.000,00 dhe mundësohet nga buxheti i UGJ-së për vitin 2026, zëri buxhetor “Projekte me financim të brendshëm”.
- Projektet që do të financohen do të jenë 6 (gjashtë), do të jenë afatshkurtra dhe do të finalizohen brenda 6 muajve.

## KRITERE TË PËRGJITHSHME PËR APLIKIM

- Aplikimi për projektin e propozuar duhet të bëhet nga një anëtar i stafit akademik të UGJ-së.
- Aplikimet duhet të jenë në përputhje me fushat prioritare.
- Projekt - propozimi duhet të përmbajë veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor, duke përfshirë aktivitete si: trajnimet, tryezat e rumbullakëta, aktivitete promovuese, aktivitete advokuese, botim artikujsh, etj.

- Në rastet kur propozimi vjen si bashkëpunim ndërmjet stafit akademik me një biznes, apo një institucion publik qendror/vendor, aplikimi bëhet nga anëtari i stafit të UGJ-së që udhëheq projektin e kërkimit shkencor. Në këtë rast partneriteti sanksionohet me një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve.
- Përparësi do të kenë propozimet që përfshijnë studentë (Bachelor, Master, PhD) në grupet e punës.
- Projekt propozimi duhet të përjashtojë blerjen e pajisjeve dhe mjeteve laboratorike që klasifikohen në shpenzime kapitale.
- Grupi i punës për çdo projekt duhet të përbëhet nga të paktën 6 (gjashtë) anëtarë, 2 (dy) prej të cilëve duhet të jenë pjesë e stafit ndihmës-akademik ose stafit teknik.
- Çdo anëtar i grupit të punës mund të marrë pjesë në jo më shumë se 2 (dy) projekt propozime.
- Të paktën 2 (dy) studentë duhet të angazhohen për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të projektit.
- Prioritet do të kenë projekt propozimet e dorëzuara nga anëtarë të stafit akademik që nuk kanë qenë koordinatorë të projekteve fituese në thirrjet e tre viteve akademike paraardhëse, por ky kriter nuk është përjashtues.

### **DORËZIMI I APLIKIMEVE**

Nën këtë thirrje të githë aplikantët duhet të depozitojnë projekt propozimet pranë Sektorit të Marrëdhënies me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor brenda afatit të përcaktuar duke përfshirë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Përshkrimin e detajuar të projekt propozimit (Aneks 1);
- Buxhetin e detajuar të parashikuar për projektin (Aneks 2);
- Cv-në e drejtuesit të projektit;
- Marrëveshjen e bashkëpunimit në rast bashkëpunimi me bizneset ose institucionet lokale.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është 30 prill 2026, ora 16:00.

### **KALENDARI I THIRRJES**

Publikimi i thirrjes	<b>21/04/2026</b>
Afati i fundit për adresimin e pyetjeve	<b>28/04/2026</b>
Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve	<b>30/04/2026</b>
Vlerësimi i propozimeve	<b>01/05/2026 - 08/05/2026</b>
Njoftimi i fituesve	<b>11/05/2026</b>
Nënshkrimi i kontratës	<b>18/05/2026</b>

**Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor**

**Prof. asoc. Merita Isaraj**

3